



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa për ndihmë financiare në vlerë prej 60,000.00 € (gjashtëdhjetë mijë euro), për t'i ndihmuar me nga 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro) familjarët e dy punëtorëve që tragjikisht humbën jetën në Minierën e Artanës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervat dhe transferohen te nën programi Thesari me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi transferohen në llogaritë e familjarëve të përcaktuara sipas të dhënave bankare bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/39

Datë: 03.06.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Secila ndërmarrje publike qendrore duhet të krijojë një sistem të mirëfilltë dhe të njëzuar të menaxhimit të kontratave komerciale.
2. Asnjë ndërmarrje publike qendrore nuk mund të lidhë kontratë komerciale pa pëlqimin e ministrit përgjegjës nëse kontrata përmban:
  - 2.1. klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh ndërkombëtar;
  - 2.2. klauzolë për zbatimin e së drejtës së huaj; ose
  - 2.3. detyrim të ndërmarrjes publike qendrore për të paguar dënim kontraktues ose dëmshpërblim të likuiduar, nëse dënimi ose dëmshpërblimi tejkalon gjithsej 5.000,00 € (pesë mijë euro).
3. Çdo kontratë komerciale mes një ndërmarrjeje publike qendrore dhe një operatori ekonomik të regjistruar në Republikën e Kosovës duhet të jetë në njërën ose të dy gjuhët zyrtare.
4. Të gjitha ndërmarrjet publike qendrore duhet të ushtrojnë kujdes që shpenzimet operative dhe punësimet e reja të mos cenojnë likuiditetin e ndërmarrjes.
5. Asnjë ndërmarrje publike qendrore nuk mund të caktojë pagë në lartësi mbi 2.500,00 € (dy mijë e pesëqind euro) në muaj për një zyrtar të saj pa pëlqimin e ministrit përgjegjës.
6. Secila ndërmarrje publike qendrore duhet të mirëmbajë sajtin e vet dhe të botojë dokumentet që kërkohet të jenë publike sipas ligjit.
7. Secila ndërmarrje publike qendrore që ofron shërbime për qytetarët duhet të mundësojë pagimin elektronik të faturave.
8. Ndërmarrjet publike qendrore në sektorin e ujërave duhet të planifikojnë zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale.

9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i Ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
  - 2.1. z. Bajram Mustafa, kryesues dhe drejtor;
  - 2.2. znj. Nora Ibishaga, drejtores;
  - 2.3. z. Bislim Fetahaj, drejtor; dhe
  - 2.4. z. Edin Hajdarpašić, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- KRU "Mitrovica" Sh.A.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej dymbëdhjetë milionë euro (12,000,000.00 €), me qëllim të zbatimit të Pakos Emergjente Fiskale të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit Nr. 01/19, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 06/25.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Kontigjenca në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, me kod 28900 dhe atë nga kategoria e shpenzimeve kapitale shuma prej dymbëdhjetë milionë euro (12,000,000.00 €).
3. Mjetet nga pika 1. i këtij vendimi transferohen në Ministrinë e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike me kod 204, në nën programin Ndërmarrësia me kod 49400 në kategorinë e shpenzimeve Subvencionet dhe Transferet shuma prej shtatë milionë euro (7,000,000.00 €) dhe në nën programin Njësia për Politika dhe Monitorim të NP me kod 23300 në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere shuma prej pesë milionë euro (5,000,000.00 €).
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve strategjike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për fillimin e procedurave për krijimin e mekanizmit për mbulimin e obligimeve të sigurimit kufitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë për vitin 2020.
2. Autorizohet Ministria e Financave dhe Transfereve në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet relevante të zhvillojë procedurat përkatëse për krijimin e mekanizmit sipas pikës 1 të këtij Vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/39

Datë: 03.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për fillimin e procedurave për themelimin e një mekanizmi të përbashkët me Republikën e Shqipërisë, për mirëmbajtjen e rrugëve të përbashkëta në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.
2. Autorizohet Ministria e Financave dhe Transfereve për zhvillimin e procedurave përkatëse për themelimin e mekanizmit sipas pikës 1 të këtij Vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe në konsultim me ministrinë tjera përgjegjëse.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

---

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë